



KUVENDI I SHQIPËRISË
GRUPI PARLAMENTAR ‘MIQTË E FËMIJËVE’

RREGULLORE E BRENDSHME

Tiranë, Mars 2016

Kjo rregullore u përgatit me mbështetjen e UNICEF Shqipëri, në kuadër të mbështetjes për fuqizimin e punës së Kuvendit të Shqipërisë, për promovimin dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri.

Ajo u përgatit në konsultim të vazhdueshëm me deputetet që përbëjnë Grupin Parlamentar “Miq të Fëmijëve” dhe shërben si udhëzues për funksionimin sa më të mirë të këtij Kaukusi Parlamentar, bazuar edhe në eksperiencën e vendeve të tjera në hemisferën perëndimore, ku grupe të tilla funksionojnë për të lobuar dhe avokuar për të drejtat e fëmijëve.



Përgatitur më Tiranë, Mars 2016

1.1 Qëllimi

Anëtarët e GPMF bien dakord dhe pranojnë që të jenë anëtarë me të drejta të plota në këtë grupim duke pranuar në të njëjtën kohë që të respektojnë qëllimet, objektivat, rregullat dhe parimet e punës si dhe të bashkëpunojnë për të nxitur nisma dhe veprime të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e të drejtave të fëmijëve dhe të të rinjve në vend.

Qëllimi i Rregullores: Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave përmes të cilave anëtarët/anëtares do të zhvillojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre për të avokuar për të drejtat e fëmijëve si dhe do të zhvillojnë nisma dhe iniciativa të përbashkëta në emër dhe në kuadër të GPMF.

1.2 Pjesëmarrja/Anëtarësia në GPMF

Pjesëmarrja e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë në GPMF është e hapur për çdo deputet, të çdo grupi parlamentar ose deputet i pavarur.

Anëtarësia është përgjegjëse për t'u përfshirë dhe kontribuar në nismat dhe aktivitetet e vendosura bashkërisht.

Ata kanë të drejtë vendimmarrje dhe kurdo është e mundur vendimet e tyre merren me konsensus.

1.3 Kryesia e GPMF

Kryetari është përgjegjës për drejtimin e mbledhjeve/takimeve të GPMF. Ai raporton një herë në vit në seancë plenare të Kuvendit, për veprimtarinë e GPMF, nismat dhe aktivitetet e përbashkëta dhe rezultatet e arritura.

GPMF ka 3 Zv. Kryetare, të cilat janë përgjegjëse për përcaktimin e agjendës së mbledhjeve të GPMF dhe për propozimin e nismave dhe aktiviteteve kryesore të grupit. Si rregull, vendimet mes tyre merren me konsensus. Kur kjo nuk është e mundur vendoset me shumicë të thjeshtë.

Zv.Kryetaret e GPMF janë përgjegjëse për bashkëorganizimin dhe drejtimin e mbledhjeve/takimeve, asistencë për kryetarin dhe së bashku me të shërbejnë si zëdhënës të jashtëme të grupit.

Zv/Kryetaret raportojnë para anëtarëve të GPMF mbi rezultatet e arritura nga nismat dhe aktivitetet e përbashkëta.

1.4 Mbledhjet/Takimet e GPMF

Mbledhjet/Takimet periodike të anëtarëve dhe komiteteve të GPMF për të diskutuar mbi aktivitetet dhe nismat e përbashkëta do të mbahen 1 herë në 3 muaj. Kur është e nevojshme takimet mund të jenë edhe më të shpeshta. Koha, vendi dhe programi i takimeve do të përcaktohet nga zv/kryetaret.

3 Zv/Kryetaret duhet të takohen të paktën një herë në muaj për të koordinuar GPMF-në dhe veprimtarinë e tij.

Mbledhjet/takimet e GPMF zhvillohen në prani të më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij. Si rregull, vendimet merren me konsensus dhe kur ai nuk është i mundur merren me shumicë vote të anëtarëve të pranishëm.

Një herë në vit, anëtarët e GPMF do të njihen nga Kryetari dhe zv.kryetaret në mënyrë të hollësishme me rezultatet e arritura përgjatë një viti aktiviteti pune të GPMF.

Në mbledhjet/takimet e GPMF mund të marrin pjesë edhe deputetë të tjerë, që nuk janë anëtarë të tij, për pa të drejtë vote, (në rast se është e nevojshme vendimmarrja me votim).

Mbledhjet/takimet mund të kryhen në mjediset e Kuvendit ose në mjedise të tjera të përshtatshme.

1.5 Komitetet e GPMF

Anëtarët e GPMF munt të organizohen në grupe më të vogla, në formë komitetesh si:

- Komiteti për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna;
- Komiteti për të Miturit në Konflikt me Ligjin;
- Komiteti për Fëmijët në Institucione Publike;
- Komiteti për Shëndetin dhe Mirëqenien e Fëmijëve;
- Komiteti për Marrëdhëniet me OSHC-të;
- Komiteti për Buxhetin e Fëmijëve.

Komitetet përbëhen nga 3-4 deputetë secili dhe kryesohen nga njëra prej Zv/Kryetareve të GPMF.

Komitetet e GPMF kanë të drejtë të propozojnë dhe ndërmarrin nisma e iniciativa të lidhura me çështjet respektive që mbulojnë në zbatim të objektivave strategjike.

Komitetet mblidhen dhe funksionojnë sipas rregullave të përcaktuara për komisionet e përhershme në Rregulloren e Kuvendit.

1.6 Të drejtat e anëtarëve

Çdo anëtar/e ka të drejtë:

- Të propozojë nisma apo aktivitete për t'u vendosur në planin strategjik apo në agjendën e mbledhjes së GPMF;

- Të informohet për çdo mbledhje/takim të GPMF si dhe për çdo informacion tjetër lidhur me GPMF;
- Të kërkojë takime sqaruese apo informuese me zv/kryetaret apo të gjithë anëtarët;
- Të largohet nga GPMF me pëlqimin e tij/saj, duke njoftuar me shkrim Kryesinë e GPMF dhe stafin mbështetës të GPMF;

1.7 Vendimmarrja

Çdo anëtar i *GPMF* ka të drejtën e një vote.

Si rregull vendimet merren me konsensus. Nëse konsensusi nuk arrihet vendimet merren me votim të hapur.

1.8 Njoftimet në GPMF

Stafi mbështetës i GPMF ka për detyrë të njoftojë të gjithë anëtarët/anëtarët e GPMF për çdo informacion dhe takim, event, aktivitetet të parashikuar, nëpërmjet:

1. Adresës së e-mail/it,
2. Celularit

1.9 Dispozita të Fundit

Çdo anëtar i GPMF ka të drejtë të paraqesë propozime për ndryshimin e kësaj rregulloreje, të cilat shqyrtohen në mbledhjen më të parë. Ndryshimet e propozuara miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të GPMF.

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të GPMF.